



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 103/2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9643, DATË 20.11.2006,
“PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose

mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.”.

2. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) vërtetim mbi gjendjen gjyqësore ose një dokument, të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”.”

3. Kudo ku përmenden, në titull dhe në përmbajtjen e këtij neni, fjalët “kandidatë ose ofertues” zëvendësohen me fjalët “operator ekonomik”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 13.12.2018